

## FJALORI I RI ARABISHT-SHQIP

Botimi më i ri, «Fjalori arabisht-shqip», plotëson mozaikun e fjalorëve të gjuhëve lindore në gjuhën shqipe. Fjalori është i shoqëruar me shpjegime të hollësishme dhe me barasvlerësit përkthimorë dhe përbën një nga botimet e para të këtij lloji në tregun e botimeve shqipe. Autori i tij është Sulejman Tomçini, një diplomat i njohur karriere, me përvojë të gjatë pune në vendet arabe (Algjeri, Egjipt, Arabi Saudite) dhe në sektorin e gjuhës arabe në Radiotelevizionin Shqiptar. Ai i ka nisur studimet e larta për gjuhën arabe në vitet gjashtëdhjetë në Moskë, por, për arsye politike të kohës, i përfundoi ato në kryeqytetin e Irakut, Bagdad.

Për përgatitjen e këtij fjalori autori është këshilluar me shumë fjalorë të tjerë të botuar në vendet arabe, në Moskë dhe në Shqipëri.

Një fjalor i këtyre përmasave botohet për herë të parë në Shqipëri. Me gjithë vonesën prej disa dhjetëvjeçarësh, kjo vepër i vjen gjuhësisë shqiptare në një moment të volitshëm e të dobishëm, i vjen në një kohë kur duhen parë me një sy vlerësues e kritikë lidhjet e vjetra dhe të reja të arabishtes me shqipen, si dhe prurjet e gjuhës arabe në shkencat tona humane. Ajo përcakton, në një farë mënyre, edhe nivelin me të cilin duhet të përballet gjuhësia jonë bashkëkohore në momentin që do t'u rikthehet kontakteve dhe komunikimit me gjuhët e lindjes.

Ky fjalor paraqet leksikun dhe frazeologjinë e gjuhës standarde arabe. Ai mbështetet në leksikun që gjendet në tekstet e librave, gazetave, revistave dhe letrave anembanë botës arabe, që nga Iraku deri në Marok. Ky leksik përdoret, gjithashtu, në fjalimet zyrtare publike, në radio e televizion, si dhe në ceremonitë fetare.

Morfologjia dhe sintaksa e arabishtes së shkruar është në thelb e njëjtë për të gjitha vendet arabe. Ndryshimet në leksik kufizohen kryesisht në lëmin e termave të veçantë. Kështu, gjuha standarde vazhdon, ashtu siç dhe ka bërë përgjatë shekujve në të shkuarën, të sigurojë unitetin gjuhësor të botës arabe. Ajo siguron një mjet

komunikimi që mbulon hapësirën e gjerë gjeografike me dialekte të shumta lokale dhe gjerësisht të ndryshme. Në të vërtetë, ajo u jep popujve arabë të shumë vendeve ndjenjën e identitetit dhe vetëdijen e trashëgimisë së tyre të përbashkët.

Që në zanafillë, ky fjalor u hartua mbi parimet shkencore deskriptive (përshkruese). Ai përmban vetëm fjalë dhe shprehje të gjetura në kontekst gjatë leximit të gjerë të literaturës së çdo disipline ose që, mbi bazën e treguesve të tjerë, mund të tregohet se janë në mënyrë të pakundërshtueshme pjesë e leksikut aktual. Aty renditen fjalët dhe frazat klasike të stilit elegant retorik krahas për krahas me fjalë të krijuara rishtazi, ashtu sikurse gjenden neologjizma, kalke (përkthime të huazuara), huazime dhe shprehje bisedore. Terminologjia lokale, veçanërisht për shumë institucione publike, zyra, tituj dhe çështje administrative është zhvilluar në disa vende arabe. Meqenëse fjalori mbështetet kryesisht në gjuhën e përdorur të vendeve që kufizohen me Mesdheun lindor, termat lokalë zyrtarë dhe administrativë janë të këtyre vendeve. Për përdoruesin i cili punon me materiale që kanë një karakteristikë të dallueshme krahinore, do të ishte mirë që t'i referohej një fjalori apo glosari të përshtatshëm dialektesh.

Leksiku gazetaresk është pak a shumë i vogël dhe mjaft i standardizuar e, si rrjedhim, mbulohet lehtësisht në një fjalor. Nga ana tjetër, leksiku i teksteve shkencore dhe teknologjike nuk është i standardizuar. Ndikimi i qytetërimit perëndimor e ka përballur botën arabe me problemin serioz gjuhësor të shprehjes së një numri të madh dhe gjithnjë në rritje të koncepteve të reja, për të cilat nuk ekziston asnjë fjalë në arabishte. Krijimi i një terminologjie shkencore dhe teknologjike mbetet ende një sfidë e madhe intelektuale. Ngurrimi për të huazuar në masë nga gjuhët evropiane ka nxitur përpjekjet për të krijuar terma sipas gjedheve fjalëformuese arabe. Në dhjetëvjeçarët e fundit, janë propozuar shumë terma në revista të ndryshme dhe në botime të posaçme. Relativisht, pak prej tyre kanë hyrë në përdorimin e përditshëm. Megjithatë, në fjalor janë përfshirë terma teknikë që kanë dënduri të konsiderueshme në veprat e botuara ose që për specialistë të fushave të ndryshme janë të njohur dhe konsiderohen prej tyre si terminologji e standardizuar.

Fjalët klasike janë një tjetër problem i veçantë. Në përgjithësi,

autorët bashkëkohorë arabë vazhdojnë të ndjekin me besnikëri traditën klasike dhe përdorin shpesh fjalë që kanë qenë arkaike që në Mesjetë. Përdorimi i elementeve klasike nuk është i kufizuar vetëm të letërsinë artistike. Arkaizmat mund të shfaqen edhe në mes të një artikulli gazete. Kurdoherë që synohet një efekt estetik apo retorik, kurdoherë që gjuha synon të jetë më shprehëse sesa thjesht përcjellja e informacionit, autorët priren të enden në arabishten e vjetër dhe në idiomat klasike. Ato janë mjete letrare artistike dhe stilistike të rendit të parë. Ato zgjojnë te lexuesi imazhe nga pasazhe të memorizuara të literaturës së lashtë dhe kontribuojnë në shijimin e tij estetik. Gjithsesi, në literaturën e kohëve më të fundit ka një prirje drejt rrjedhshmërisë dhe lehtësisë së leximit në stil, ndonëse është e qartë që nuk mund të bëhet një dallim i prerë mes përdorimit të gjuhës së gjallë dhe asaj të vjetruar. Prandaj, shumë fjalë arkaike të vjela në materialin burimor janë përfshirë në këtë fjalor, ndonëse ato mund të mos jenë më pjesë të leksikut të gjallë dhe përdoren vetëm nga një grup i vogël i njohësve të mirë të letërsisë. Pamundësia e përfshirjes së krejt leksikut të vjetër është e qartë. Përdoruesit, që ndesh një fjalë të vjetër arabe të cilën nuk e kupton, do t'i duhet të konsultojë një fjalor të arabishtes klasike.

Me qëllim që të sjellë një informacion të sintetizuar, i cili pritet nga një fjalor i këtyre përmasave, janë përzgjedhur fraza idiomatike dhe fjali që ilustrojnë përdorimin. Në fjalor janë përfshirë shumë sinonime me qëllim që të përcaktohen sa më saktë caqet e përmbajtjes semantike, brenda së cilës mund të përdoret një fjalë e dhënë.

Leksiku i arabishtes moderne nuk është ende i standardizuar, skajet e shtrirjes së tij në kohë janë të vështira për t'u përcaktuar. Këto përfundime dalin nga vetë karakteri i arabishtes moderne: një gjuhë e shkruar, e ndikuar fuqimisht nga normat tradicionale e që megjithatë i kërkohet të shprehë një mori konceptesh të reja të huaja, jo vetëm për një vend, por për shumë të tilla të shpërndara në një hapësirë të gjerë gjeografike. Fonologjia, morfologjia dhe sintaksa arabe kanë mbetur relativisht të pandryshuara që nga kohët e hershme, ashtu si dhe një pjesë e madhe e leksikut. Këtu, besnikëria tradicionale ndaj normave të lashta gjuhësore dhe ndaj modeleve të literaturës klasike, veçanërisht ndaj Kuranit, ka pasur

efektin e ruajtjes së gjuhës të paprekur gjatë shekujve.

Botimi i këtij fjalori, i konceptuar si një prurje e re dhe e bollshme në fushën e leksikografisë, do t'u vijë në ndihmë studiuesve, studentëve shqiptarë në vendet arabe dhe studentëve në fakultetet e medresetë islame në Shqipëri, Kosovë, Mal të zi, Maqedoni etj. Kjo vepër e rëndësishme është një kontribut i çmuar për kulturën dhe qytetërimin islam në trojet tona.